



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA
GJYKATA KOMERCIALE
DHOMAT E SHKALLËS SË DYTË

K.DH.SH.II.nr.1040/22

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS – Dhomat e Shkallës së Dytë, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët: Dren Rogova, kryetar, Ramush Bardiqi dhe Krenar Berisha, anëtarë, në konfliktin administrativ sipas padisë së paditësit “Hidro Forca” me seli në Deçan, përfaqësuar me autorizim nga D.O., avokat në Prishtinë, kundër të paditurës Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinorë (MMPH), me bazë juridike anulim vendimi, duke vendosur lidhur me ankesën e paditësit të ushtruar kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Administrative, A.nr.1132/2018 të datës 21.05.2021, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 20.09.2023, merr këtë:

A K T G J Y K I M

- I. APROVOHET** si e bazuar ankesa e paditësit “Hidro Forca”, me seli në Deçan
- II. NDRYSHOHET** Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Administrative, A.nr.1132/18 i datës 21.05.2021 ashtu që: APROVOHET kërkesëpadia e paditësit “Hidro Forca” me seli në Deçan dhe ANULOHET vendimi Nr. 18/719/1-ZSP/93/18 i datës 10.04.2018, ndërsa lënda i kthehet organit administrativ në rivendosje dhe rivlerësim.

A r s y e t i m

Me Aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Administrative, A.nr.1132/18 i datës 21.05.2021, është refuzuar kërkesëpadia e paditësit “Hidro Forca” me seli në Deçan, të cilën ka kërkuar që të anulohet vendimi Nr.18/719/1-ZSP/93/18 datë 10.04.2018 i të paditurës dhe të vazhdohet me procedurën administrative nr.18/719/1-ZSP/93/18 për dhënien e pëlqimit mjedisor për ndërtimin e Hidro Centralit në Lumin Strazhë, sipas kërkesës së ndërmarrjes Hidro Forca sh.p.k ose çështja sa i përket pezullimit i kthehet organit administrativ në rivendosje

Kundër këtij aktgjykimi ka ushtruar ankesë paditësi për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës nga Neni 39 i LKA, konstatimit të gabuar apo jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të drejtës materiale, me propozimin që të aprovohet ankesa e palës paditëse, të anulohet aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Administrative, A.nr.1132/2018 i datës 21.05.2021, ashtu që çështja të kthehet në rivendosje.

Kolegji i Dhomës së Shkallës së Dytë, vlerësoi ligjshmërinë e aktgjykimit të ankimuar në kuptim të nenit 12 të Ligjit nr.08/L-015 për Gjykatën Komerciale, dhe nenit 194 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, në drejtim të thënieve në ankesë, dhe pas shqyrtimit edhe të shkresave tjera të lëndës vlerëson se:

- Ankesa është e bazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësi me padi ka kërkuar që të anulohet vendimi Nr.18/719/1-ZSP/93/18 datë 10.04.2018 i të paditurës dhe të vazhdohet me procedurën administrative nr.18/719/1-ZSP/93/18 për dhënien e pëlqimit mjedisor për ndërtimin e Hidro Centralit në Lumin Strazhë, sipas kërkesës së ndërmarrjes Hidro Forca sh.p.k ose çështja sa i përket pezullimit i kthehet organit administrativ në rivendosje.

Gjykata e shkallës së parë, ka mbajtur seancën e shqyrtimit kryesor dhe pasi vlerësoi vendimin e kundërshtuar dhe pas administrimit të provave, vërtetoi gjendjen faktike mbi bazën e këtyre provave akt i datë 10.04.2018, vendim nr.18/719/1-ZSP/03/18 datë 10.04.2018 padi datë 15.03.2018, akt përcjellës datë 09.02.2021, 08.02.2021 komunikim elektronik 05.02.2021, 04.02.2021, 03.02.2021, akt datë 03.04.2018, vendim datë 03.04.2018, informatë (nuk identifikohet data). Pas vlerësimit të provave dhe vërtetimit të fakteve të çështjes konform tyre, gjykata e shkallës së parë në kuptim të nenit 43, 46.2, lidhur me nenet 5, 6, 38 të Ligjit për Konfliktet Administrative e refuzoi kërkesëpadinë e paditësit me arsyet se padia e datës 15.03.2018 - kërkesëpadia referohet në kompensim të dëmi material dhe moral për plagjiaturë të projektit - raport vlerësimi i ndikimit në mjedis për ndërtimin e Hidrocentralit në Lumin “Strazhë”, Komuna Kaçanik ndërsa projektin e të paditurit ta shpall të pavlefshëm, Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, kurse bashkangjitur në shkresa të lëndës po ashtu konstatohet shqyrtimi i raportit VNM nga komisioni për shqyrtimi e raporteve të VMN, duke pasur parasysh këtu edhe Informatën “Hidro Forca“, Sh.p.k Deçan për ndërtimin e hidrocentralit në lumin “Strazhë Komuna e Kaçanikut e cila po ashtu përfshinë procedurën e këtu paditësit nga aplikimi i datës 21.09.2016. Në këtë kuptim gjykata e shkallës së parë ka vlerësuar se vendimi i organit të shkallës së dytë, të cilin e atakon paditësi, është i drejtë dhe i bazuar në ligj, dhe se e paditura drejtë ka zbatuar Ligjin për Procedurën e Përgjithshme Administrative përkatësisht nenin 85 të të njëjtit.

Dhomat e Shkallës së Dytë, duke u nisur nga gjendja e tillë e çështjes dhe pas ekzaminimit të aktgjykimit të ankimuar, dhe shkresave të tjera të lëndës, e duke pasur parasysh edhe pretendimet ankimore, gjen se aktgjykimi i kontestuar është i përfshirë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 par.2 të LPK pika n).

Sipas vlerësimit të Kolegjit, aktgjykimi i atakuar është përfshirë me shkelje esenciale pasi që, aktgjykimi është i pakuptueshëm, kontradiktor me vetvete si dhe nuk janë treguar fare arsyet për faktet vendimtare. Kjo për faktin se sipas vlerësimit të Dhomave të Shkallës së Dytë të kësaj gjykate, në procedurën gjyqësore para gjykatës së shkallës së parë, kjo gjykatë nuk ka dhënë arsye për faktet vendimtare në veçanti lidhur me pretendimet në konfliktin administrativ që i referohen kërkesës së palës për të anuluar vendimin e organit administrativ për pezullimin e dhënies së pëlqimit mjedisor. Kjo gjykatë gjen se gjykata e shkallës së parë nuk i ka dhënë përgjigje pretendimeve se si ka ardhur deri te vlerësimi se vendimi i të paditurës për pezullimin e pëlqimit mjedisor është i drejtë në mbështetje të një raporti civilo-juridik ku e paditura nuk ka fare legjitimitet dhe interes juridik në këtë çështje juridike. Për Kolegjin e kësaj gjykate nuk është

i qartë fakti se si ka ardhur gjykata e shkallës së parë deri te baza juridike dhe përfundimi kur ka konstatuar si të ligjshëm dhe të drejtë vendimin kontestues lidhur me pezullimin e pëlqimit mjedisor. Kjo për faktin se nuk është e qartë se cila pengesë ligjore paraqitet nga padia në procedurën civile mes dy personave fizik – në të cilën mbështetet gjykata, kur e pezullon procedurën administrative, e në veçanti se çfarë impakti procedural ka padia në mes të këtyre palëve për kompensimin e dëmit në procedurën administrative pranë të paditurës. Lidhur me këto pretendime të paditësit, gjykata e shkallës së parë është mjaftuar vetëm me refuzimin e kërkesës pa përcaktuar se cila dispozitë ligjore është cenuar apo cili kusht ligjor është plotësuar që e paditura ta pezullojë procedurën e dhënies së pëlqimit në procedurën administrative. Po ashtu, nuk është sqaruar se si ka ardhur organi administrativ e rrjedhimisht edhe gjykata e shkallës së parë deri te përfundimi juridik se organi administrativ drejtë ka ardhur te përfundimi për pezullimin e kërkesës. Në këtë drejtim, gjykata e shkallës së parë fare nuk ka dhënë arsytim nëse organi administrativ ka pasur bazë ligjore për pezullimin e kërkesës për pëlqim mjedisor në një bazuar mbi një padi kompensimi mes dy personave fizik, qoftë edhe nëse njëri është pronar i këtu paditëses si person juridik dhe çka ndikon ky proces në nxjerrjen apo mos nxjerrjen e aktit administrativ.

Kolegji vlerëson se gjykata e shkallës së parë gabimisht ka aplikuar edhe dispozitat ligjore kur ka konstatuar se për vlerësimin e ligjshmërisë së vendimit të kontestuar iu ka referuar Nenit 85 të LPPA me pretendimin se kemi të bëjmë me çështje paraprake. Lidhur me këto pretendime gjykata e shkallës së parë është mjaftuar vetëm me një provë që shprehet nga një padi mes personave fizik I.F. dhe V.G., për kompensimin e dëmit në çështje civile, legjitimiteti i të cilëve nuk ndërlihet me procesin administrativ para të paditurës lidhur me dhënien e pëlqimit mjedisor.

Kolegji i kësaj gjykate duke shqyrtuar vendimin përfundimtar të organit administrativ të paditurës me të cilën është pezulluar dhënia e pëlqimit mjedisor të paditësit, vlerëson se vendimi i organit administrativ të paditur rezulton se është përfshirë me të meta juridike për shkak të cilave nuk mund të shqyrtohet ligjshmëria e tij, sepse nuk është përmbajtjesor dhe nuk është argumentuar siç parashihet me Nenin 46, 47 dhe 48 të LPPA-së. Përkatësisht nga përmbledhja e konstatimeve faktike bazuar në dëshmitë të cilat janë shtjelluar me prova, nuk dëshmohet se është vërtetuar në mënyrë të plotë gjendja faktike, respektivisht organi administrativ gabimisht ka zbatuar dispozitat ligjore kur ka vendosur të pezullojë kërkesën e paditësit për nxjerrjen e aktit administrativ.

Nga gjendja e tillë e çështjes e administruar si më lartë, bazuar në pretendimet ankimore dhe provat që gjenden në shkresat e lëndës, Kolegji i Dhomave të Shkallës së Dytë të gjykatës Komerciale, vendosi që ta ndryshojë Aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Administrative, A.nr.1132/18 të datës 21.05.2021 dhe të aprovojë kërkesëpadinë e paditësit dhe ta anulojë vendimin Nr. 18/719/1-ZSP/93/18 të datës 10.04.2018, ashtu që lëndën ta kthej tek organi administrativ në rivendosje dhe rivlerësim.

Organi administrativ detyrohet që në afatin e paraparë ligjor, ashtu siç parashihet me Nenin 65 të LKA, pasi të vërtetoi në mënyrë të plotë dhe të drejtë gjendjen faktike, të merr parasysh

kërkesën e palës për nxjerrjen e aktit administrativ dhe të njëjtën ta vlerësojë sipas akteve e juridike në fuqi, e po ashtu të vlerësojë se cila është lidhja kauzale e kontestit mes personave fizik në procedurën administrative të paditëses. Lidhur me këto pretendime organi administrativ duhet të nxjerr vendim meritator të bazuar në prova dhe më pas të zbatojë drejtë normat juridike ashtu që të jep arsye të qarta lidhur me mënyrën e vendosjes.

Prandaj, kjo gjykatë tani për tani nuk mund të pranoj si të drejtë një konstatim të tillë të paraqitur në aktgjykimin e ankimuar, sepse ka të meta për të cilat nuk mund të ekzaminohet, dhe se është juridikisht i paqartë dhe i paqëndrueshëm.

Mbi këtë bazë e në mbështetje të nenit 44 dhe 43 par.2 të LKA-së, lidhur me nenin 201 të LPK-së, të aplikueshëm sipas nenit 63 të LKA-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhoma e Shkallës së Dytë

K.DH.SH.II.nr.1040/22 datë 20.09.2023

**Kryetar i Kolegjit, gjyqtari
Dren Rogova**